



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit - Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës - Председник Општине
Belediye Başkanı

01 Nr. 092/22 Dt. 01.07.2022



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren- Prizren Belediyesi

Zyra e Kryetarit

DATE:	01.07.2022
PËR:	Zyrën Kombëtare të Auditimit
NGA:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
LENDË:	PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2021

Të nderuar,

Në pajtim me nenin 14, pika 1 deri në 7 të Rregullorës së punës për zbatimin e auditimit dhe Planeve të Veprimit të Zyres Kombëtare të Auditimit të aprovuar me datën 21.06.2019, kemi përgatitur Planin e Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dalura nga Raporti Final i Auditimit për Komunën e Prizrenit për vitin financiar të përfunduar me 31.12.2021.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
LAKTARSHI QORRIZ/CI LAKTARSHI QORRIZ/CI DATE RECEIVED SL/ET/ED:		4 07. 2022	
No. na Org. Org. Jedini, Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. fletëve B. Stranica No. Pages
04	47	1142	11

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2021

Nr	Komponenta e auditimit(kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	Çështja A1 - Dobësitë në regjistrimin e pasurive	Pasuritë kapitale jo financiare të blera gjatë vitit 2021, ishin në shumën 14,164,936€, ndërsa në regjistrin e përgjithshëm të pasurive kapitale ishin regjistruar 12,234,965€ me një diferencë prej 1,929,971€. Në mungesë të funksionimit të sistemit e-pasuria, pasuritë nën 1,000€ mbahen në një fletë Exceli. Megjithatë, shuma e prezantuar në pasqyrat financiare ishte mbivlerësuar për 99,855€, si rezultat i saldoeve të gabuara ndër vite.	Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e Komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat e pasurisë kapitale dhe jo kapitale. Po ashtu, duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për aplikimin e sistemit të e-pasurisë për regjistrimin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë jo kapitale në përputhje me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Hapi 1: Të gjithë pasuritë kapitale dhe jokapitale të cilat sipas rregullores për pasuri trajtohen si të tilla, do të regjistrohen në regjistrin e pasurisë, ndërsa do të mbahet një listë në exel për pagesat kapitale të cilat janë paguar nga kategori e investimeve kapitale, por të cilat, nuk janë regjistruar në regjistrinë e pasurisë, pasi që nuk trajtohen si pasuri Hapi 2: Në mungesë të funksionimit të sistemit e-pasuria deri në funksionalizimin e sistemit nga ministria e linjës përkatëse, pasuritë nën 1,000€ do të regjistrohen në Excel, në përputhje me rregulloren 02/2013	Zyrtari/ja e pasurisë, ZKF Zyrtarët e logjistikës në administratë, DKA dhe DSH	Gjatë vitit 2022 Afati i implementit i të gjeturës lidhur me E-pasuri mvaret nga funksionalizimi i softverit nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
2	Çështja A2 - Dobësitë lidhur me pranimin e mallit/shërbimit	Për kontratën "Furnizimi me material ndërtimor për familjet skamnore dhe rasteve sociale", për 37 përfitues, më datë 16.12.2021 është kryer pagesa	Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë mbikëqyrje dhe kontrolle adekuate/ rigoroze mbi kontratat për projekte kapitale dhe mbi komisionet/organet	Hapi 1: Procesi i menaxhimit të kontratave do të bëhet konformë procedurave të parapara në rregulloren dhe udhëzuesin e prokurimit publik, si dhe rregullores 01/2013 shpenzimi i	Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, Menaxheri i Projektit/Kon	

		në shumën 98,235€, për të cilën komisioni për pranimin e materialit, më datë 10.12.2021, ka konstatuar se materiali është pranuar si në sasi ashtu edhe në cilësi. Dokumenti i pranimit ishte nënshkruar edhe nga mbikëqyrësi kryesor. Sipas ekzaminimit (për shtatë përfitues), kemi vërejtur se në dy raste, materiali ndërtimor nuk ishte dërguar tek përfituesit edhe pse ekziston fletëdërgesa në emër të tyre. Vlera e materialit të paguar dhe pa pranuar të rasteve të ekzaminuara është 10,783€.	mbikëqyrëse të punëve/materialit të furnizuar. Po ashtu, menaxhmenti të shtojë mekanizmat për kontroll më të avancuar në mbikëqyrjen e kontratave dhe pagesave për projektet e tilla.	parave publike; Hapi 2: Pas ngritjes së çështjes nga auditori, OE fitues ka bërë furnizimin me material për këto dy raste (dëshmitë e pranimit dhe verifikimi nga ana e komisioni se materiali është dorzuar sipas sasisë së kontraktuar)	tratës/organi mbikëqyrës, Komisioni i pranimit të furnizimeve	E zbatuar për çështjen e ngritur
3	Çështja A3 - Nënvlërësimi i të arkëtueshmeve e për taksat nga mbeturinat	Të arkëtueshmet nga taksat për mbeturina, të prezantuara në Raportin dhe Aneksin e pasqyrave financiare ishin prezantuar 4,090,393€, shumë e cila është mbivlerësuar për 268,532€.	Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë, që janë marrë veprimet e nevojshme korrigjuese për harmonizimin e të dhënave ndërmjet sistemit për të hyrat nga taksat për mbeturina, në mënyrë që të sigurohet informacioni i saktë i llogarive të arkëtueshme.	Hapi 1: Do të shqyrtohen rastet e faturave të anuluar nga komisioni i formuar dhe do të kemi informacione të sakta për llogarit e arkëtueshme	Sektori i mjedisit dhe menaxhimit të mbeturinave	Zbatimi i plotë i këtij rekomandimi nuk do të mundë të ndodhë brenda vitit 2022, por është proces i vazhdueshëm.
4	Çështja A4 - Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike	Bazuar në testet e kryera rezulton se kishte raste të klasifikimit jo të duhur të shpenzimeve si në vijim: - Shpenzimet për subvencione, për furnizim me dru për familjet e skamnorrëve, në shumën 55,000€, ishin regjistruar në	Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë, që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/ kategoritë adekuatë të buxhetit (apote ri destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që	Hapi 1: Në buxhetin e komunës për vitin 2022 janë ndërmarrë veprime për çështjen e keqklasifikimit, një pjesë e projekteve të investimeve kapitale të trajtuar si keqklasifikime në vitet paraprake, tani janë planifikuar në MSH dhe Subvencione duke rritur	Njesitë buxhetore, ZKF, Kryetari i Komunës	Janë marrë veprime konkrete për minimizimin e projekteve si të keqklasifikuara në buxhetin e vitit 2022, ne konsiderojmë se ky

		<p>katëgjinë mallra & shërbime në vend që të klasifikohen në katëgjinë e subvencioneve dhe transfereve;</p> <p>- Shpenzimet për pasuritë nën 1,000€, në shumë 114,586€, ishin regjistruar në katëgjinë e investimeve kapitale në vend që të klasifikohen tek katëgjinë e mallrave dhe shërbimeve;</p> <p>- Shpenzimet e participimeve me fermerët për projekte të ndryshme bujqësore, në shumë 720,185€, ishin regjistruar në katëgjinë e investimeve kapitale në vend që të klasifikohen tek subvencionet dhe transferet; dhe</p> <p>- Shpenzimet për shujta të punonjësve arsimor, në shumë 85,553€, ishin regjistruar në katëgjinë ekonomike të subvencioneve në vend që të klasifikohen tek katëgjinë ekonomike e pagave dhe mëditjeve.</p>	<p>pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate.</p>	<p>fondin e planifikuar në katëgjinë e subvencioneve, ku projektet kapitale nga Drejtoria e Bujqësisë, janë të paraparë në katëgjinë e subvencioneve</p> <p>Hapi 2: Kujdesi në kodet e shpenzimeve do të jetë në çdo kohë, në mënyrë që shpenzimi të jetë adekuat.</p>		<p>rekomandim është zbatuar</p>
5	<p>Çështja B1 - Mos prezantimi/ shpalosja e detyrimeve kontingjente</p>	<p>Në raportin vjetor financiar ishin shpalosur detyrime kontingjente në shumë 560,374€, përkatësisht shtatë (7) raste të cilat nuk e plotësonin kriterin e detyrimeve kontingjente (pagesa përmes përmbarimit). Bazuar në dëshmitë</p>	<p>Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë, që detyrimet kontingjente janë prezantuar drejtë në PFV. Duhet të sigurohen të dhënat e sakta dhe të plotë mbi këto detyrime nga zyra ligjore dhe të njëjtat të përcillen në zyrën e</p>	<p>Hapi1: Në mungesë të stafit në zyrën e përfaqësuesit ligjor, stafi i angazhuar nga OE me kontratë për shërbimet juridike në Komunë, do të rishikojnë të dhënat për detyrimet kontingjente dhe do të harmonizojnë listën e obligimeve kontingjente, duke bashkëpunuar ngushtë me ZKF</p>	<p>ZKF dhe Zyra e Përfaqësuesit ligjor</p>	<p>Janar 2023</p>

		e ofruara, në vitin 2020 Komuna do të duhej të shpaloste detyrime kontingjente mbi 10,000,000€.	financave si hartuese të PFV.	që kjo çështje të korrigjohet para dorëzimit të aneksit të detyrimeve kontingjente për raportim në PVF e vitit 2022.		
6	Çështja A5 - Mangësi në kontratën kornizë, mospërdorimi i sasive të planifikuara (indikative)	Komuna kishte nënshkruar për tri vite, nga viti 2021 - 2024, kontratën kornizë "Intervenimi në infrastrukturë për rastet e fatkeqësive natyrore dhe eliminimi i deponive ilegale në Komunën e Prizrenit", me çmime për njësi shuma totale e të cilave është 804.96€. Ndërsa vlera e parashikuar e kësaj kontrate ishte 1,500,000€. Në kontratë nuk ishin parashikuar sasitë e përafërta (indikative), sipas kërkesës ligjore të RrUOPP, përkatësisht nenit 18.7. Përveç kësaj, një parashikim i përafërt ka mundur të bazohet në konsumin e më hershëm duke e korrigjuar me variacionet e njohura sipas nevojës.	Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë, në rastin e zbatimit të kontratave me çmime për njësi, të këtë përdorim efikas të kontratave, ashtu që në proceset prokuruese të përdoren procedurat e duhura të llojeve të kontratave.	Hapi 1: Të kërkoj nga KRPP dhe organet gjegjëse harmonizim të dispozitave ligjore në mes vete, lidhur me sasitë dhe njësitë e kërkuara, si dhe të rregulloj dhe sqaroj edhe më tepër rolin e çmimit të peshuar te ofertat, të cilat janë publikuar me çmim të peshuar për njësi; Hapi 2: Të kërkoj prej njërive të kërkesës që të bëjnë të gjitha përpjekjet për të siguruar SASITË E PËRAFËRTA qoftë të materialit të kërkuar apo edhe shërbimeve të cilat do të jenë pjesë e kontratës dhe mundësisht sa më tepër ti shmangen ofertimit me çmimet për njësi.	Shefi i Prokurimit	Zyra e prokurimit ka ndërmarrë veprimet që nga data e pranimit të raportit përfundimtar të ZKA dhe do të merrë masat e duhura për këtë çështje në vazhdimësi gjatë vitit

7	<p>Çështja A6 - Shpenzime për procedurat përmbartimore</p>	<p>Shuma e pesë pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendime gjyqësore/ përmbartimore ishte 528,426€, prej tyre 10,386€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/ përmbartimit; dhe - Për 18 raste, shpenzimet e përmbartimit dhe përfaqësimit të ndodhura për shujta dhe paga jubilarë në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, si rezultat i obligimeve që rrjedhin nga kontratat kolektive, ishin prej 833,970€.</p>	<p>Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë, që paraprakisht të eliminohen shkaqet e vonësive, të sigurohen fondet e nevojshme, planifikim të mirëfilltë si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që të shmangen shpenzimet shtesë.</p>	<p>Hapi1: Çdo drejtori do ti dorëzoj me kohë faturat, për ti proceduar për pagesë, me qëllime që të shmangen pagesat përmes përmbartuesit;</p> <p>Hapi 2: Çështja e përmbartimit për shujta dhe paga jubilarë, me shumë i takon përgjegjësisë së nivelit qendror, pavarësisht të kërkesave nga ana e komunës, gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore, nuk po krijohen linja buxhetore, ku përmes kategorisë së pagave dhe mëditjeve të paguhen në mënyrë të rregullt obligimet e dalura nga kontrata kolektive, konsiderojmë që kjo çështje mundë të mos zbatohet në tërësi edhe këtë vit nga komuna.</p>	<p>Njësitë buxhetore, ZKF</p>	<p>E pa zbatueshme në tërësi për vitin 2022.</p>
8	<p>Çështja A7 - Pagesa e automjetit për zjarrfikës pa raport pranimi</p>	<p>Më datë 25.02.2021, Komuna kishte lidhur kontratë me Operatorin ekonomik për "Furnizim me automjet special për zjarrfikës", në shumën 119,000€. Operatori ekonomik nëpërmjet procedurës përmbartimore ka kërkuar nga Thesari në Ministrinë e Financave për pagesën e faturës. Fatura ishte e pa nënshkruar nga zyrtarët e Komunës dhe e pa protokoluar në Komunë. Thesari, më 30.12.2021, kishte realizuar pagesën në shumën</p>	<p>Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë se komisioni i formuar për pranimin e mallit, të jetë me personel kompetent, në mënyrë që të pranoj mallin e porositur sipas procedurave dhe kriterëve të specifikuar.</p>	<p>Hapi 1: Pasi që rasti konkret është kryer si pagesë për mes thesarit, ne nuk kemi mundësi që ky proces të korigjohet sipas procedurës së kërkuar të pagesave, mirëpo ne do ti ndërrmarrim veprimet e duhura për të gjitha procedurat tjera në menaxhimin e kontratave në drejtorin tonë, si: Procesi i menaxhimit të kontratave do të bëhet konformë procedurave të parapara në rregulloren dhe udhëzuesin e prokurimit publik(RrUOPP), si dhe rregullores 01/2013 për shpenzimet e parasë publike.</p>	<p>Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, Menaxheri i Projektit/Kontratës dhe organi mbikqyrëste në Drejtorinë e Emergjencave, ZKF</p>	<p>Periodha e zbatimit për raste të ngjashme: Korrik-Dhjetor 2022</p>

		<p>121,746€, përfshirë shpenzimet e procedurës përbarimore në shumën 2,746€.</p> <p>Komisioni i caktuar nga Komuna nuk kishte bërë pranimin e automjetit me arsyetimin se nuk janë kompetent për pranimin teknik të automjetit.</p>				
9	<p>Çështja A8 - Tejkallim i furnizimeve të sasive të përcaktuara në kontratën kornizë</p>	<p>• Bazuar në kontratën kornizë 'Sigurimi Fizik loti I' në vlerë totale 703,992€ nga viti 2020 deri me 2023 me çmimin për njësi orë të shërbimit 2,71€ pa deklarimin e devijimit +/- 30%, në aneksin 1, për muaj ka parapa 7,440 orë të shërbimit për 10 lokacione. Bazuar në shpenzimet e analizës së furnitorëve për vitin 2021, ishte paguar shuma 521,770€ apo 192,535 orë pune. Pra, bazuar në aneks kontratë, në periudhën njëvjeçare për vitin 2021 do të realizoheshin 12 muaj*7,440 orë = 89,280 orë pune, ndërsa janë tejkalluar 103,255 orë pune, apo në shumën financiare 279,821€.</p> <p>• Komuna ka aplikuar kontratën kornizë të AQP-së "Furnizim më bukë dhe brumëra tjerë Kategoria 5 loti II me +/- 30%, por ka tejkallim të</p>	<p>Rekomandimi A8</p> <p>Kryetari duhet të sigurojë, që më rastin e pranimin të shërbimeve, furnizimeve të parashihen të gjitha pozicionet/ artikujt përmbledhës të situacioneve paraprake si parakusht i faturimit dhe ekzekutimit të pagesave. Njëkohësisht, të sigurojë se shërbimet/ furnizimet, janë kryer sipas sasisë dhe vlerës së përcaktuar me kontratë.</p>	<p>Për kontratën 'Sigurimi Fizik loti I' në vlerë totale 703, 992 €, kjo kontratë ka përfunduar me 31.05.2022, pasi që janë shpenzuar mjetet e planifikuar, tutje janë iniciuar procedurat e reja tenderuese dhe implementimi saj do të bëhet konformë kërkesave të preparë në kontratë, rregullave të prokurimit dhe rregullores 01/2013 për shpenzimin e parasë publike</p> <p>Kontrata Kornizë nenin 38 të kontratës specifikohet që kontrata për njësi mundë të rritet ose zvogëlohet për 30%. Andaj diferenca prej :8.656.00 euro është si rrjedhojë e kësaj rritje të</p>	<p>Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, Menaxheri i Projektit/Kontratës dhe organi mbikëqyrës në Drejtorinë e Administratës</p> <p>Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, Menaxheri i Projektit/Kon</p>	<p>Rekomandim i mbyllur për kontratën në fjalë</p> <p>Periudha e zbatimit: korrik-dhjetor 2022</p>

		<p>pozicionit 2 të Kifle kroasan të kontraktuara 118,200 copë ndërsa vetëm në pesë (5) fatura të paguara është furnizuar me 178,904 copë që ka tejkalim 25,244 copë ose në shumën 3,938€.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në kontratën për Transportin e mësimdhënësve udhëtarë, për dy faturat e muajit Mars dhe Maj-Qershor, ka pasur tejkalim për shumën 8,656€ krahasuar me atë të paraparë në kontratë, për arsye të numrit të punonjësve që është shtuar. 		<p>numrit të mësimdhënësve udhëtar Në vitin 2022 do të harmonizohet dhe implementohet sipas ligjit në fuqi.</p>	<p>tratës dhe organi mbikëqyrës në drejtorinë e Arsimit</p>	
10	<p>Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave</p>	<p>Nga analiza e data bazës së furnitorëve, kemi vërejtur se gjatë vitit 2021, ishin kryer pagesa në shumën 7,323,931€ apo 1,549 raste të pagesave ndaj furnitorëve nga lista e marrë, të cilat e kanë tejkualur afatin ligjor prej 30 ditësh deri në dy vite.</p>	<p>Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë, që obligimet të planifikohen/ buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i Komunës me kosto shtesë të përmbarimit.</p>	<p>Hapi 1: Drejtori i ekonomisë dhe financave, përmes qarkores së brendshme, i ka informuar të gjithë udheqësit e programeve buxhetore, se dorëzimi i faturave nga drejtorit, në zyren e thesarit, të bëhet deri më datë 10 të çdo muaji, me qëllim që zyrtarët/et përgjegjës për certifikimin e pagesave ti procedojnë brenda afatit ligjor.</p> <p>Hapi 2: Zyra e thesarit në mënyrë të vazhdueshme procedonë lëndë të cilat janë të kompletura me dokumentacionin e kërkuar sipas kërkesave ligjore, duke respektuar afatin ligjor të pagesave prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të faturës në protokollin e komunës.</p>	<p>Zyrtarët financiar të drejtorive, Zyrtarët e thesarit, ZKF dhe Drejtori i financave</p>	<p>Gjatë vitit 2022</p>
11	<p>Çështja B3 - Mangësi në</p>	<p>Pas analizës së bërë, në lidhje me zbatimin e zbritjes së</p>	<p>Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë</p>	<p>Sipas njoftimit të datës 24.01.2022 nga ana e Departamentit të Tatimit</p>	<p>Departamenti i Tatimit në</p>	<p>Është zbatuar</p>

	menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë	lejuar për vendbanimin parësor dhe zbatimit të vendimit për regjistrimin e numrit personal, janë identifikuar mangësitë si në vijim: Për 5,103 tatimpagues, është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, duke u mbështetur në nenin 11 – “Zbritjet për vendbanim parësor”, mirëpo kjo zbritje është bërë për pronat e personave për të cilët nuk ishte evidentuar numri personal, ku për pasojë rezulton më pak të hyra nga tatimi në pronë për rreth 114,817€. Për më tepër, te këta tatimpagues janë 307 prej tyre për të cilët nuk ishte përcaktuar kategoria e pronës.	bashkëpunim dhe komunikim më të mirë në mes të Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventual.	në Pronë në MFPT, jemi njoftuar se Tatimpaguesit të cilët nuk kanë pasur nr. personal dhe nuk e kanë deklaruar deri më 30.11.2021, nuk përfshihen në zbritjen për Banimin Parësor për asnjë nga Pronat Rezidenciale që posedon.	Pronë në kuadër të MFPT	
12	Çështja B4 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga taksat për mbeturina	Bazuar në të dhënat e Komunës, për 2,932 amvisëri ishte bërë faturimi në shumën 12€/ vit pa ndonjë bazë ligjore, përderisa tarifa vjetore ishte përcaktuar 54€/ vit. Si rezultat i këtij nën faturimi, Komuna do të mbledhë më pak të hyra në shumën prej 123,144€.	Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë, që do të kryhen analiza të mirëfillta nga menaxhimi i mbeturinave në mënyrë që të arrihen objektivat e Komunës në krijimin e sistemit të qëndrueshëm financiar. Po ashtu, të merret në konsideratë që paraprakisht të rifreskohet data baza e ngarkesave si dhe të bëhen ndryshimet dhe aprovimet në rregullore nga organi legjislativ për lirin apo përcaktimin e tarifave për amvisëritë e caktuara.	Hapi 1: Është aprovu rregullorja për menaxhimin e mbeturinave , Nr.001/011-38749, të datës 15 mars 2022, ku është përfshi edhe ngarkesa për qytetar jo rezident të komunes së Prizrenit, për të cilët ngarkesa në fatura, nuk është e njejtë me qytetarët rezident.	Sektori i mjedisit dhe menaxhimit të mbeturinave	I zbatuar sa i përket çështjes së faturimit prej 12€

13	<p>Çështja B5 - Mos harmonizimi ndërmjet akt emërimit dhe koeficienteve për kompensimin e pagave</p>	<p>Në katër raste të testuara, kishte mos harmonizim ndërmjet koeficienteve dhe pozitive në akt emërim dhe listën e pagave si: Zyrtari për buxhet dhe financa në Drejtorin e Arsimit, sipas akt emërimit kishte koeficientin gjashtë (6), ndërsa në listën e pagave paguhet si zyrtar i lartë për buxhet dhe financa me koeficient tetë (8). Ndërsa, në drejtorinë e kadastrit, tre (3) zyrtar sipas akt emërimit kishin pozitën gjeometër me koeficient pesë (5), ndërsa në listën e pagave figuronin si gjeodet dhe paguhen me koeficientin shtatë (7).</p>	<p>Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë, që të gjithë të punësuarit paguhen në bazë të pozitive zyrtare që janë të emëruar dhe të siguroj harmonizimin e akt emërimeve me listën e pagave për të gjithë të punësuarit.</p>	<p>Hapi 1: Sa i përket çështjes së harmonizimit ndërmjet aktemërimeve dhe koeficienëve për kompensim të pagave, Zyra e Personelit së bashku me Zyren e Kryetarit brenda vitit 2022, do ti zbatojë dhe do ti realizojë të gjeturat dhe rekomandimet e auditorit lidhur me këtë çështje.</p>	<p>Zyra e Personelit, Kryetari i Komunës</p>	<p>Dhejtor 2022</p>
14	<p>Çështja A9 - Pagesa e ekzekutuar pa situacion të pranuar</p>	<p>Komuna kishte nënshkruar kontratën për "Hapjen dhe mirëmbajtjen e rrugës nga fshati Jeshkovë deri në shtëpinë malore në Struzhë", në vlerë 11,620€. Situacionet për kryerjen e punëve nuk ishin nënshkruar nga Organi mbikëqyrës. Si pasojë, pagesa është kryer përmes procedurës përmbare.</p>	<p>Rekomandimi A9 Kryetari duhet të shtojë kontrollet me rastin e ekzekutimit të punëve, ashtu që të sigurojë se është bërë pranimi i situacioneve të nënshkruara para pranimi të faturave, dhe të sigurojë se pagesat janë kryer me rregull dhe në kohë.</p>	<p>Hapi 1: Është shtuar kontrolli i brendshëm që Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, menaxheri i projektit/organi mbikëqyrës, të angazhohet në zbatimin e detyrave dhe obligimeve që rrjedhin nga rregulla dhe udhëzuesi i prokurimit publik, në lidhje me menaxhimin e kontratave dhe faturat nuk janë proceduar për pagesë nga ana e zyrtarëve/e përgjegjës të drejtorisë sonë, para se të dëshmohet përmes specifikacionit për punët e përfunduara (të nënshkruara nga përgjegjësit e kontratës dhe OE) dhe raportit për pranim të punëve të përfunduara</p>	<p>Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, Menaxheri i Projektit/Kontratës/organi mbikëqyrës në Drejtorinë për Turizm dhe Zhvillimit Ekonomik</p>	<p>E zbatuar për natyrën e çështjeve të ngjajshme.</p>

15	Çështja B6 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë	Komisioni i inventarizimit të pasurisë ishte formuar me kohë, mirëpo nuk kishte arritur të përfundoj raportin mbi gjendjen e inventarizimit.	Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë, që procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë kryhet me kohë dhe këto raporte të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe ti paraprijnë përgatitjes së PFV, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet saktë.	Hapi 1: Regjistrimi i inventarizimit në tërë organizatën buxhetore, përgatitja e raportit; Hapi 2: Harmonizimi i raportit të inventarizimit me gjendjen e pasurisë në regjistra e pasurisë.	Komisioni i inventarizimit Kryesuesi i Komisionit për inventarizim, Zyrtaari/ja e pasurisë, ZKF	Dhjetor 2022 Janar 2023
16	Çështja C1 - Shlyerja e borxheve për mbeturina	Bazuar në të dhënat e Komunës, brenda periudhës janar – mars 2021, janë shlyer borxhet për 18 amvisëri në shumën 6,426 €, pa u formuar komisioni për shqyrtimin e ankesave të taksapaguesve. Kjo praktikë e tillë ishte ndërprerë pas trajtimit të kësaj çështje në auditimin paraprak dhe në zbatim të rekomandimit ishte formuar komisioni për shqyrtimin e ankesave të taksapaguesve, mirëpo ende nuk kishte filluar me trajtimin e shlyerjes së borxheve.	Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë, që Komisioni i formuar të rishikoi faturat e shlyera ndër vite dhe të bëj një vlerësim të gjendjes faktike të borxheve.	Hapi 1: Është formuar komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave të qytetareve. Hapi 2: Janë duke u shqyrtur ankesat e qytetarëve, ndërkoh do të shqyrtohen edhe rastet e faturave të shlyera.	Komisioni i Ankesave, Sektori i mjedisit dhe menaxhimit të mbeturinave	Gjatë vitit 2022

Komuna e Prizrenit ka të themeluar Grupin Punues dhe ka të emëruar Koordinatorin e procesit dhe se për progresin e zbatimit të rekomandimeve tuaja do të raportojmë me datë 30.09.2022 dhe 15.03.2023, ashtu siç e parasheh pika 5 e nenit 14 e Rregullorës së punës për zbatimin e Auditimit dhe Planeve të veprimtimit dhe siç parashihet edhe në Procedurat Standarte të trajtimit të rekomandimeve, të nxjerrura nga Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm me datë 01.07.2019.

Qershor, 2022
Prizren

pen Kryetari i Komunës së Prizrenit:

/ z. / Shaqir Totaj

